



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë
Bachelor në “Biologji - Kimi”
ofruar nga
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr. Anila Hoda
2. Prof.Dr. Mirela Lika (Çekani)

Mars/2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në "Biologji Kimi", ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Biologji-Kimi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Biologji-Kimi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 167, datë 28.05.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 258, datë 28.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19-20: 16 PAE / 8 PAK 20-21: 22 PAE / 5 PAK 21-22: 22 PAE / 6 PAK 22-23: 20 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	19-20: 11 studentë 20-21: 12 studentë 21-22: 8 studentë 22-23: 9 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit “Bachelor” në “Biologji-Kimi” ofrohet nga Departamenti Biologji-Kimi, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Përmes programit Bachelor në “Biologji Kimi” synohet përgatitja e profesionistëve me formim 3 vjeçar në fushën teorike dhe laboratorike në mënyrë specifike në fushën e biologjisë dhe kimisë. Institucioni ka një historik të gjatë, duke filluar që prej vitit 1957 si Institut i Lartë Pedagogjik, e më pas i emërtuar si Universiteti “Luigj Gurakuqi”, me VKM Nr. 167, datë 28.05.1996, ku citohet shprehimisht edhe dega e Biologji-Kimisë. Forma e regjistrimit të diplomës për këtë program studimi është miratuar me UMAS Nr. 258, datë 28.05.2021 dhe Me UMAS Nr. 578, datë 04.10.2022 është miratuar ofrimi i këtij programi studimi edhe në gjuhën angleze.

Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” ofrohet në përputhje me kërkesat aktuale dhe ka një ndërthurje të mirë të teorisë me praktikën që mundëson formimin profesional të studentëve. Programi i studimit realizohet me 180 ECTS dhe kohëzgjatja normale e tij është tre vite akademike. Programi organizohet edhe në lëndë dhe module të integruara, si dhe me zgjedhje në përputhje me aktet ligjore në fuqi, konkretisht me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar. Studentët në varësi të preferencave të tyre mund të zgjedhin dhe të orientohen në lëndët me zgjedhje që ofron programi. Madje dhe provimin e formimit ata mund ta zhvillojnë vetëm në “Biologji”, ose vetëm në Kimi”, por jo në të dyja bashkë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

GVJ përbëhet nga Prof. Anila Hoda dhe Prof. Mirela Lika. GVJ në gjithë procesin e vlerësimit të jashtëm është mbështetur nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Ersi Dako. GVJ shfrytëzoi RVB dhe një numër të konsiderueshëm evidencash, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikat, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit Biologji - Kimi. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor dhe aktiviteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjentet e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”. GVJ vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj.

Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet e paraqitura më poshtë në raport.

Draft-Raporti u përcoll në IAL përmes AMS më datë 12.02.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 20/3 Prot., datë 12.02.2024.

IAL përcolli përgjigjen përmes AMS më datë 20.02.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 512/2 Prot., datë 19.02.2024, përmes së cilës ka konfirmuar se nuk ka komente për Draft-Raportin. Për sa më lart, Draft-Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Biologji Kimi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>USH ka një historik të gjatë, duke filluar që prej vitit 1957 si Institut i Lartë Pedagogjik, e më pas i emërtuar si Universiteti “Luigj Gurakuqi”, me VKM Nr. 167, datë 28.05.1996, ku citohet shprehimisht edhe dega e Biologji-Kimisë.</p> <p>USH ka hartuar strategjinë e zhvillimit (Ev 8.VIII) dhe në përputhje me të synon të punojë në nivel lokal, rajonal e global për përhapjen e dijeve dhe konsolidimin e vlerave akademike, kulturore e kombëtare (RVB, fq 4)</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” ofrohet nga Departamenti Biologji-Kimi, Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë, ashtu siç sanksionohet edhe në Strategjinë e Zhvillimit DBK (Ev. D5). Programi synon të krijojë, transmetojë, zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve (Ev. I-1 Statuti, neni 4). Programi i studimit përmban elementët e domosdoshëm për të përmbushur misionin dhe për të realizuar objektivat për formimin e thelluar teorik - praktik të specialistëve në “Biologji - Kimi”. (Syllabuset)</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<p>Institucioni ka ndërtuar strategjinë e zhvillimit, së fundmi për periudhën 2022 – 2026 (Ev. 9 dhe Ev. 8), që synon së pari të plotësojë aspiratat e studentëve, të sigurojë arsim të lartë cilësor, të zhvillojë partneritet të qëndrueshëm. Departamenti i Biologji-Kimisë ka hartuar Strategjinë e tij të zhvillimit për periudhën 2023-2026 (Ev. D5) ku shprehet se synimi strategjik i mësimdhënies është ngritja cilësore e mësimdhënies dhe përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në punë kërkimore. Programi i studimit është hartuar në përputhje me statutin e USH (Ev. 1.I) dhe zhvillohet në përputhje me rregulloren e studimeve (Ev. D3). Gjithashtu Departamenti synon ngritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërinë e diplomave në tregun e punës. DBK bën përpjekje për të krijuar një mjedis dinamik ku gërshetohet tradita me kërkesat e aktualitetit dhe zhvillohet në përshatje dhe zbatim të strategjisë për zhvillim të institucionit, e cila u evidentua nga GVJ gjatë takimeve me stafin akademik dhe autoritetet drejtuese, si dhe në vizitat e ambienteve të laboratorëve.</p>



	<i>(Vizita në institucion)</i>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimit në institucion dhe vizitës në ambientet e auditorëve dhe laboratorëve, GVJ konstaton se institucioni ka përvojë të gjatë në ofrimin e programeve të studimit në fushën e Biologji-Kimisë.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i cili përbëhet nga 4 departamente dhe një qendër studimore <i>(Aneks I/5)</i>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Matematikës; - Departamenti i Biologji Kimisë; - Departamenti i Fizikës; - Departamenti i Infermierisë; - Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës. <p>Departamenti i Biologji Kimisë është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”.</p> <p>Institucioni ka përvojën dhe kapacitetet akademike për të përmbushur të gjitha objektivat e programit të studimit. Stafit akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e biologji kimisë. <i>(CV e personelit akademik)</i>. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit Biologji - Kimi për vitin akademik 2022- 2023 përbëhet nga 20 PAE, me kualifikimin 3 Prof., 5 Prof.As., 7 Dr., dhe 5 Msc., dhe 6 PAK, me kualifikimin 3 Dr., dhe 3 Msc.</p> <p>GVJ u njoh me infrastrukturën mësimore që disponon institucioni, USH, si dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës, DBK ku zhvillohet ky program studimi. Për zhvillimin e programit mësimor institucioni ka në dispozicion të studentëve salla për leksione dhe seminare të pajisura me videoprojektorë, laboratorët e biokimisë, botanikës, kimisë organike, mikrobiologjisë, fiziologjisë së bimëve, fiziologjisë shtazore, muzeu i zoologjisë etj. <i>(Ev. 4.5 vizita në institucion)</i>. Një rëndësi të veçantë ka Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujërave, i ngritur në vitin 2001, me financim të Konferencës së Rektorëve Gjermanë dhe menxhim nga pala austriake. Sot ky laborator njihet si Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Eolfdieter Sixl”. <i>GVJ evidenton si praktikë të mirë shërbimet që ofron kjo qendër për të krijuar të ardhura nga të tretët për USH sipas çmimeve të miratuara nga Senati Akademik i USH, duke shërbyer njëkohësisht si laborator reference për Qarkun e Shkodrës. Në qendër zhvillohen gjithashtu aktivitete kërkimore në kuadër të përgatitjes së tezave të Masterit.</i></p>
	<p>Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e rinovuara të bibliotekës. GVJ vizitoi ambientet e bibliotekës dhe u informua për rregulloren e funksionimit, listën e librave etj, gjatë takimit me</p>

	punonjësit dhe përmes shqyrtimit të dokumentave në dosjen e programit. (Ev. 4.6; 4.7, vizita në institucion).			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Ky Fakultet ka katër departamente dhe një Qendër studimi (<i>shih standardi 1.1, kriteri 4</i>) dhe ofron disa programe studimi. Departamenti i Biologji Kimisë është përgjegjës për programin Bachelor në “Biologji Kimi”, Master Shkencor në “Biologji Mjedisore” dhe Master Profesional në “Mësuesi për CLAB në lëndët Biologji- Kimi”. (Ev. 1.1). Programi i studimit Bachelor në “Biologji Kimi” ofrohet si program me kohë të plotë. Përsa i përket kodifikimit të programeve të studimit, IAL ka përcjellë në MAS dokumentacionin me propozimet përkatëse dhe është ende në proces.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” nuk bie ndesh me interesa kombëtare. Programi i studimit është në përputhje me misionin, vizionin dhe fushën e vperimtarisë së USH dhe ofrohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me Statutin dhe rregulloret e USH. USH ka përvojë në ofrimin e këtij programi studimi, duke u zhvilluar në mënyrë dinamike në përputhje me kërkesat e kohës, si dhe legjislacionin në fuqi. Institucioni ka kapacitetet humane dhe infrastrukturore për ofrimin e këtij program studimi. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”, DBK përfshin dhe struktura bashkëpunuese, si departamentet e tjera të FSHN-së, njësitë administrative, laboratorët, sekretaria (Ev.D1). Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i USH. Organizimi i strukturave realizuese të programit dhe funksionimi i tyre është në përputhje me rregulloret dhe aktet e tjera të USH (Ev. 2-II, D1). GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi

	<p>aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit (Ev. 2-II, D1).</p> <p>Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimore të dokumentuar në raportet përkatëse të FSHN (Ev. 7.1; 7.2). Në Departament funksionon dhe Komisioni për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, i cili në përputhje me rregulloren e DBK (neni 15) përbëhet nga 3 anëtarë të stafit akademik dhe një student dhe kryen detyra të përcaktuara qartë. USH ka ngritur dhe NJSBC e cila jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit si dhe përpunimit dhe krahasimit statistikor të të dhënave në bazë të indikatorëve Europeanë (Ev. 17-XVII). Madje kjo njësi merret dhe me përpunimin e informacionit mbi ngarkesën e stafit akademik (Takimi me përfaqësues të zyrës).</p> <p>Në takimin me stafin, pedagogët referuan që janë të përfshirë në procedurat vlerësuese e përmirësuese të syllabuseve, si dhe në hartimin e aplikimin e projekteve kërkimore shkencore (Takimet në institucion).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Biologji-Kimi”, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit (Ev. D22), Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (Ev. 1.2), si dhe me IAL partnere në Europë, Amerikë etj. Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundur:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Realizimin e praktikës në terren për studentët; – Realizimin e temave të diplomave (Master); – Mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve (Ev. 1.3).
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Studentët e programit realizojnë praktika në terren, si pjesë të programit mësimor dhe për këtë Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (Ev. 1.2). Praktikrat mësimore, laboratorike zhvillohen duke shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të vetë institucionit (Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit, vizita në Institucion). <i>GVJ i sugjeron institucionit të zgjerojë bashkëpunimin dhe me institucione të tjera private apo publike, si mundësi për të mbështetur dhe zgjeruar kapacitetet për realizimin e praktikave mësimore, jo vetëm të atyre në terren.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVB deklaron se DBK harton raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, raporte të cilat janë pjesë e analizës së punës mësimore kërkimore hartuar nga Përgjegjësi i Departamentit (RVB, fq.5). <i>GVJ konstaton se raportet e analizës mësimore dhe kërkimore janë në nivel të njësisë kryesore dhe jo të njësisë bazë (Ev. 7.1; 7.2). Në këto</i></p>

	<i>raporte mungon ky raportim siç deklarohet në RVB, vetëm pohohet mbi bashkëpunimet ndërinstucionale në nivel të njësisë bazë ose kryesore (Ev. 7.1, fq 11, pika 6). GVJ sugjeron që DBK të përgatisë raporte mbi impaktin e bashkëpunimit me institucione të ndryshme në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare. Njësia kryesore analizon punën mësimore dhe shkencore në mënyrë periodike. Institucioni duhet të zgjerojë bashkëpunimin dhe me institucione të tjera, krahas AKZM për të mbështetur formimin praktik të studentëve DBK duhet të hartojë raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Institucioni deklaron se ofron Bachelor në “Biologji-Kimi” në gjuhën angleze në vitin 2022 (Me urdhër të MAS nr. 578, datë 04.10.2022) (Ev. 1.1) por <i>GVJ nuk e konstatoi një fakt të tillë, madje dhe në takimet me përfaqësues të zyrave nuk u pohua zhvillimi i mësimin në gjuhën angleze.</i> Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Referuar rregullores së studimeve në USH (Ev. 2-II), si dhe në rregulloren e DBK (Ev. D.1, kreu IV, organizimi i studimeve), rregulloren e programit të Studimit Bachelor në “Biologji Kimi” (Ev. D3):

	<ul style="list-style-type: none"> - Bsc. në “Biologji-Kimi” është program i ciklit të parë të studimeve dhe i korrespondon nivelit 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve; - Kohëzgjatja e studimeve është 3 vite akademike/6 semestra dhe ofrohet me kohë të plotë; - Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriterëve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar; - Vlerësimi në kredite: 180 ECTS/60 ECTS për vit akademik/4500 orë; - 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit; - Raporti ECTS/orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 1/1.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta; - Frekuentimi i orëve të seminareve është i detyrueshëm në masën 75%, i leksioneve në mënyrë fakultative, si dhe 100% për orët e laboratorëve dhe praktikave; - Viti akademik ka 30 javë (secili semester ka 15 javë); - Viti akademik ka 4 sezone provimi: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i paradiplomimit-për studentët e vitit të tretë, i vjeshtës-pas pushimeve verore. <p>Programi i studimit mbyllet me provim, ku studentët mund të japin provimin vetëm në fushën “Biologji” ose vetëm në fushën “Kimi”. Kjo reflektohet korrektësisht edhe në regjistrin e sekretarisë mësimore (Vizita në institucion). Në rregulloren e programit të studimit (Ev. D3, neni 35) shkruhet <i>Departamentet e “Biologji – Kimi” përcaktojnë dhe miratojnë fushat përkatëse mbi të cilat do të hartohet programi i mbrotjes së diplomës”. Megjithatë, GVJ e konsideron si pikë të dobët dhënien e provimit të formimit të ndarë vetëm në Biologji, ose vetëm në Kimi dhe sugjeron që Institucioni të organizojë provimin e formimit për studentët e programit Bachelor në “Biologji-Kimi” në të gjitha fushat njëkohësisht, ashtu siç është zhvilluar dhe programi i studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjediset akademike dhe profesionale dhe t’i pajisë me kompetencat e duhura për zgjidhjen e problematikave të ndryshme. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës në fushën e biologjisë dhe kimisë. Programi synon dhe krijimin e shprehive të veçanta në specialitete si mbrojtje mjedisi, mikrobiologji, gjenetikë, zoologji (Ev. D.2.1 plani mësimor).</p> <p>Institucioni deklaron se programi i studimit dhe plani mësimor kanë pësuar ndryshime përmirësuese në masën 20% të aprovuara nga</p>

<p>dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>MASR (Ev. 2.3; takimi me autoritetet drejtuese Dekani dhe Përgjegjësja e Departamentit). <i>GVJ konstaton se referenca e paraqitur është thjesht një shkresë përcjellëse, por nuk tregon ndryshimet e propozuara dhe masën e përfshirë.</i></p> <p>Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën në terren. Përmes kësaj ndërthurjeje, programi zhvillon tek studentët aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e biologjisë dhe kimisë. Formimi i përgjithshëm dhe aftësimi në laboratorët e institucionit krijon premisa edhe për profilizim profesional në fusha më specifike si biologji mjedisi, i cili është dhe drejtimi i studimit në Masterin Shkencor (Syllabusët; planet mësimore; Vizita në ambientet e laboratorëve).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar planit mësimor (Ev. D. 2.1) në Bachelor në “Biologji-Kimi GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Sipas planit mësimor, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kategoria A: Lëndë bazë 33 ECTS (18.33%); – Kategoria B: Lëndë karakterizuese 96 ECTS (53.33%); – Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 24 ECTS (13.35%); – Kategoria D: Lëndë plotësuese 21 ECTS (11.67%); – Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS (3.33%).
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i Studimit Biologji kimi ka të përcaktuar ngarkesën prej 4 ECTS të praktikave nësimore në terren (Ev. D.2.1). Praktikën në terren zhvillohen në vitin e parë dhe të dytë. Në Rregulloren e programit të studimit (Ev. D3), detyrimet përmbyllëse përcaktohen me provim formimi apo me temë diplome. <i>GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm me provim formimi, siç është përmendur edhe më sipër.</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>USH është IAL publike, autonome, por jo me status të veçantë. (Ev. 1-I)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të</p>	<p>Institucioni deklaron se programi i studimit Bachelor në “Biologji Kimi” është në masën 70% i ngjashëm në përmbajtje me programet me të njëjtën emërtesë që ofrohen nga Universiteti i Elbasanit</p>

njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel. së paku 70 për qind.	“Aleksandër Xhuvani”, si dhe Universiteti i Korçës “Fan S. Nnoli” (RVB, fq. 7)			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	IAL ka përcjellë në MAS dokumentacionin me propozimet përkatëse për kodikimin e programeve të studimit dhe është ende në proces. (Vizita në Institucion).			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me IAL të tjera vendase apo të huaja.			
Konkluzione	<p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore dhe ka të përcaktuar qartë ngarkesat respektive në ECTS. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në ECTS të praktikave mësimore në terren.</p> <p>Programi i studimit është në masën 70% i ngjashëm në përmbajtje me programet me të njëjtën emërtesë që ofrohen nga IAL e tjera vendase.</p> <p>Programi i studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me IAL të tjera vendase apo të huaja.</p> <p>GVJ e konsideron si pikë të dobët dhënien e provimit të formimit të ndarë vetëm në Biologji, ose vetëm në Kimi dhe sugjeron që Institucioni të organizojë provimin e formimit për studentët e programit Bachelor në “Biologji-Kimi” në të gjitha fushat njëkohësisht, ashtu siç është zhvilluar dhe programi i studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti Biologji-Kimi që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>USH është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e institucionit dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Shkodër.</p> <p>Organet kolegjiale janë Asambleja e personelit akademik, Senati</p>

	<p>Akademik, komisionet e përhershme, Rektorati, Dekanati, Bordi i Administrimit, Këshilli i Etikës. (Ev. 1-1)</p> <p>Departamenti i Biologji-Kimisë, në 3 vitet e fundit akademike, paraqitet me përbërjen si në vijim:</p> <p>20-21: 10 PAE, me kualifikimin 2 Prof.Dr., 5 Prof.As., dhe 1 Msc., dhe 15 PAK, me kualifikimin 1 Prof.As., 7 Dr., dhe 7 Msc.</p> <p>21-22: 10 PAE, me kualifikimin 2 Prof.Dr., 5 Prof.As., dhe 3 Dr., dhe 14 PAK, me kualifikimin 1 Prof.As., 6 Dr., dhe 7 Msc.</p> <p>22-23: 10 PAE, me kualifikimin 2 Prof.Dr., 5 Prof.As., dhe 3 Dr., dhe 12 PAK, me kualifikimin 6 Dr., dhe 6 Msc.</p> <p>GVJ evidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL në tabelat përkatëse ka disa mospërputhje, ndaj për të dhënat e paraqitura si më lart, GVJ i është referuar tabelave 1/1, 1/2 dhe 1/3 të tabelave përmbledhëse.</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Për realizimin e programeve të studimit të Departamentit të Biologji Kimisë, Bachelor në “Biologji-Kimi”, si dhe Master i Shkencave e Profesional angazhohet personeli ndihmës akademik dhe administrativ për realizimin e praktikave në terren, si dhe të praktikave mësimore (Ev. 7.4). Sipas tabelës 1/1, 1/2 dhe 1/3 të tabelave përmbledhëse, IAL ka angazhuar në 3 vitet e fundit akademike, 3 personel ndihmës akademik.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Personi përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij është Përgjegjësi i Departamentit (RVB fq. 8). DBK përcakton një koordinator për programin e studimit për çdo vit akademik (Ev. 2.2). Për çdo vit akademik ka një koordinator të veçantë të programit të studimit. Ky person vendoset pas diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e departamentit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti Biologji-Kimi që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</i></p> <p><i>Në vitin akademik 22-23, Departamenti përbëhet nga 10 PAE, 12 PAK dhe 3 personel ndihmës akademik.</i></p> <p><i>Institucioni përcakton një koordinator për çdo vit akademik për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Biologji-Kimisë që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” zotërojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion, gjendet informacioni për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadri i përgjithshëm formues i programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, plani mësimor, infrastruktura në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregullorja e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementi i diplomës. (Dosja e programit të studimit).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në tabelat e planit mësimor të detajuar (EV. D.2.1) jepet informacion për ndarjen e ngarkesës mësimore në vite akademike dhe semestra. Për secilën lëndë jepet informacion për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual, si dhe për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika. Në rregulloren e programit (Ev. D3) të studimit dhe në syllabuset e lëndëve përcaktohen kushtet e frekuentimit të mësimit (jo më pak se 75% e orëve totale për procesin mësimor që zhvillohet në auditor (praktikat, pasi leksionet janë fakultative) dhe në masën 100% për praktikat laboratorike dhe praktikën në terren) si dhe skema e vlerësimit të dijeve. Në rregulloren e programit të studimit, neni 21 theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20 – 40% të vlerësimit përfundimtar, dhe ky raport përcaktohet nga çdo pedagog, dhe miratohet nga Departamenti.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në takimet me studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit (Ev. 2-II) dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (Ev. D3). Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e USH.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues	Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë (Ev. D.2.2). Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e

të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<i>arsimit të lartë</i> ”, i ndryshuar. Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës. Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar (Paketat e syllabuseve).			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se programi i studimit Bachelor në Biologji-Kimi është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. GVB deklaroi se ky përmirësim kryhet sipas procedurave të përcaktuara qartë, <i>por nuk mbështetet me dokumentacion përkatës ku të tregohen ndryshimet e propozuara dhe masa e ndryshimit të kryer.</i>			
Konkluzione	<i>FSHN dhe DBK japin informacion mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit.</i> <i>Programi i studimit përmban informacion të detajuar mbi ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit.</i> <i>Në rregulloren e programit të studimit jepen kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> <i>Syllabuset janë të plota në të gjithë elementët e planit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënimit dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës, si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Praktikantët në terren, si dhe praktikantët mësimorë i bëjnë studentët të aftë për manipulim dhe punë të pavarur në fushën e biologjisë dhe kimisë. Gjatë vizitës në ambientet e USH, GVJ u njoh me politikën e institucionit për t'i vënë këto hapësira në funksion të mësimdhënies, madje edhe në shërbim të tretëve, si dhe të popullatës humane lokale, siç është rasti i Laboratorit të Mikrobiologjisë së Ujërave. (Ev. D.2.1, vizita në institucion)

<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra, si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</p> <p>Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore/ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës së nevojshme.</p> <p>Në planin mësimor vërehet një shpërndarje e harmonizuar e ECTS midis lëndëve të ndryshme duke mundësuar një formim të përgjithshëm në fushën e biologjisë dhe kimisë (anatomi njeriu, fiziologji e përgjithshme, fiziologji bimore, kimi inorganike-analitike, biologji qelizore etj) formim shkencor (gjenetikë, kimi fizike, teori evolucioni - bioteknologji etj). Në program janë përfshirë dhe lëndë të një formimi të përgjithshëm organizativ dhe të komunikimit (gjuhë e huaj, njohuri kompjuteri etj) të cilat e aftësojnë studentin edhe në fushën e organizimit, kontrollit dhe dokumentimit të aktivitetit profesional. (Ev. D.2.1, syllabuset)</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën e gjatë të ofrimit të këtij programi nga USH, si dhe mbështetur në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë.</p> <p>Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. (Ev. D.2.1)</p> <p>Në takimin me zyrën e kërkimit GVJ u informua se USH ka një sërë marrëveshesh me universitete të huaja që mundësojnë mobilitetet e stafit dhe studentëve (Ev. 1.3 ; 2.4).</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Strukturimi i programit (Ev. D.2.1), unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkures në tregun e punës publik e privat, mundësojnë transferimin e studimeve, si dhe mobilitetet e studentëve (Ev. 2.4). GVJ nuk arriti të marrë informacion mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Në takimin me përfaqësues të zyrës, GVJ u informua se institucioni bën përpjekje për gjurmimin e të diplomuarve, përmes kontaktimit me anë të telefonatave, apo email-eve, por nuk u siguroi një e dhënë e saktë mbi punësimin e të diplomuarve. <i>GVJ i sugjeron institucionit të rrisë përpjekjet për gjurmimin e studentëve dhe punësimin e tyre.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe</p>	<p>Institucioni inkurajon përditësimin e vazhdueshëm të programit të lëndëve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse, e cila pasqyrohet në syllabuset e moduleve (syllabuset). Një pjesë e pedagogëve synojnë dhe realizojnë hartimin e teksteve universitare për studentët e USH (takimi me stafin akademik). Në syllabuse është punuar për</p>

ndihmëse të viteve të fundit.	përditësimin e literaturës së huaj e ndihmuar dhe nga rikonceptimi i funksionimit të bibliotekës. Mbështetur në literaturë bashkëkohore, pedagogët e këtij programi studimi përgatisin leksione dhe materiale didaktike të shkruara për studentët.			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVB deklaron se përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”. Strukturimi i programit krijon mundësi për transferim të studimeve dhe mobilitet. (Ev. D.3). <i>Objektivat e çdo programi studimi të ofruar nga DBK, paraqiten në analizën e punës mësimore kërkimore (Ev. 2.6), por këto janë dokumenta që shfrytëzohen nga një grup i kufizuar, prandaj GVJ sugjeron që në rregulloren e programit të studimit të citohen objektivat formuese, si dhe kompetencat që synohen të arrihen përmes këtij programi studimi.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar nga stafi akademik. Përmbajtja e programit të studimit u mundëson studentëve vijimin e studimeve në ciklin e dytë. Departamenti i Biologji-Kimisë ofron dhe programin e studimit Master Profesional për Mësuesi Biologji Kimi dhe Master Shkencor në Biologji Mjedisore. (Ev. D.1). Studentët mund të ndjekin studimet Master i Shkencave dhe/ose Profesional dhe në programe të tjera studimi, që nuk ofrohen nga USH, si AML në biologji, kimi, bioteknologji molekulare dhe industriale, biologji molekulare etj (RVB, fq. 11). Në takimet në institucion u informuam se studentët që mbarojnë këtë program studimi preferojnë të vijojnë studimet Master i Shkencave në “Biologji Mjedisore” ofruar nga vetë USH (takimi me studentët).			
Konkluzione	<p><i>Përmbajtja e programit të studimit, organizimi, shpërndarja e lëndëve mundësojnë studimet të mëtejshme në USH, ose në universitete të tjera të vendit, si dhe punësimin e studentëve.</i></p> <p><i>Programi i studimit ofron mundësi për transferimin e studimeve, si dhe për mobilitetet e studentëve.</i></p> <p><i>Syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhduar nga stafi akademik.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron gjurmimin më të hollësishëm të të diplomuarve.</i></p> <p><i>Në rregulloren e programit të studimit duhet të citohen objektivat formuese të programit të studimit, si dhe kompetencat që synohen të arrihen përmes këtij programi studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbyajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVB deklaron se personeli akademik i përshtat syllabuset në përputhje me kërkesat e tregut. Gjatë vizitës në institucion (takimi me stafin, takimi me përfaqësues të zyrave), GVJ nuk iu dhanë shembuj konkretë se si realizohet përmirësimi i programeve të studimit përmes konsultimit me grupet e ndryshme të interesit, siç mund të jenë të diplomuarit. <i>GVJ sugjeron intensifikimin e konsultimeve me grupet e ndryshme të interesit, si institucionet partnere, të diplomuarit etj, për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut.</i>			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin USH ato janë në ndihmë të përmirëimit të programit të studimit.	USH deklaron se nxit përfshirjen e studentëve dhe strukturave të studentëve në diskutime për përmirësimin e programit të studimit (Ev. 2.5). <i>Por GVJ nuk konstatoi përfshirjen e të diplomuarve në një proces të tillë.</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<i>GVJ nuk konstatoi hartimin e raporteve periodike mbi përfitimet e arritura nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Përveç marrëveshjeve të bashkëpunimit, GVJ nuk konstatoi bashkëpunime konkrete të DBK me rrjete profesionistësh, shoqata etj. të cilët kontribuojnë në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>USH ka sfida në përmirësimin e programeve të studimit. GVJ sugjeron intensifikimin e konsultimeve me grupet e ndryshme të interesit, si institucionet partnere, të diplomuarit etj, për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut. USH duhet të hartojë raporte periodike dhe të zhvillojë bashkëpunime konkrete me rrjete profesionale për të përmirësuar programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbyajtjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbyajtjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika mësimore në terren, përgatitjen e detyrave të kursit, provim formimi, punë kërkimore në laborator (Ev. 2-II), si dhe leksione të hapura nga të ftuar siç është rasti i Prof. P.C (I Qershor 2021). Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca dhe seminare (takimi me stafin akademik). Vlerësimi i dijeve është i kombinuar midis atij të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në ppt., biseda interaktive me studentët, demonstrimi i procedurave praktike laboratorike, ushtrime, vëzhgime në mikroskop. Studentët punojnë në grupe të vogla në laborator. Stafi akademik ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo laboratorëve mësimore. Në takimin me stafin akademik, GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; inkurajohet mësimi interaktiv, debati etj. (Takimi dhe vizita në institucion).</p> <p>DBK eksperimenton dhe implementon forma inovative dhe ndërdisiplinore, siç është përdorimi i paketës Microsoft Office, MS Teams etj. (Ev. XX; 3.1)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore, e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët mësimorë dhe shkencorë (Laboratori i mikrobiologjisë).</p> <p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trajnuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. (Ev. D.8 takimet dhe vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë pedagogjike në lëndët që zhvillon. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të</p>

<p>ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>studentëve etj. (CV e stafit akademik, vizita në institucion). Stafi akademik inkurajon punën e pavarur të studentëve përmes prezantimit të projekteve, detyrave të kursit, pjesëmarrjes aktive të tyre në seancat laboratorike, praktikave mësimore dhe në terren.</p> <p>Personeli akademik është aftësuar dhe ka realizuar me sukses dhe metodat e inovative të mësimdhënies, si dhe përdorimin e platformave online si MS Teams etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësisht të pyetësorit të vlerësimit (Ev. 3.2).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësisë të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqëse për studentin, stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie, si me anë të projektorëve, prezantime PPT, metoda interaktive, metodat online duke shfrytëzuar platformat që janë të përdorshme si për studentët dhe pedagogët, përfshirjen e tyre në trajnime dhe konferenca shkencore, apo projekte së bashku me pedagogët e tyre. <i>USH ka laboratorin e trajnimit të vazhdueshëm për trajnimin e vazhduar të stafit akademik me metodat bashkëkohore të mësimdhënies.</i> (Ev. 3.3; D.10) të cilën GVJ e konsideron si praktikë të mirë. Gjithashtu, USH nxit mobilitetet dhe shkëmbimin e stafit akademik në kuadër të bashkëpunimeve në projekte ndërkombëtare (Ev. 1.3; D.22).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve përfshijnë leksione, seminare, punë laboratorike, praktika në terren etj.</i></p> <p><i>Stafi akademik përdor forma alternative dhe inovative të mësimdhënies dhe për këtë gëzon mbështetjen e plotë të institucionit.</i></p> <p><i>USH ka ngritur laboratorin e trajnimit të vazhdueshëm, duke i mundësuar stafit trajnimin me metodat bashkëkohore të mësimdhënies, të cilën GVJ e konsideron si praktikë të mirë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësisë profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive,</p>	<p>Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të</p>

dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme. bëhen publike dhe njihen nga studentët.	cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e studimeve të USH përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive (Ev. D1, D3). Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive (Syllabuset e lëndëve).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e studimeve të USH, në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe provimi përfundimtar. (Ev. D3. syllabuset)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, si dhe provimi i diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Provimi bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar sipas specifikës së programit të lëndës. (Ev. D3. Rregullore e programit të studimit, neni 28; syllabuset)
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Stafi akademik kujdeset për përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Për të arritur këtë, stafi akademik angazhohet në një proces periodik ku përfshihen edhe studentët, dhe ata reflektojnë mbi mendimet dhe sugjerimet e tyre. Stafi akademik bën përpjekje për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies duke marrë seriozisht në konsideratë kontributin e studentëve, opinionet dhe sugjerimet e studentëve (Ev. 2.5).
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët e ndryshëm të përmendur dhe më sipër. USH i kushton një vëmendje të veçantë punës praktike të studentëve, përmes eksperimenteve laboratorike, por edhe praktikave në terren. Gjatë procesit mësimor dhe praktikës në terren studentët asistohen nga pedagogët, si dhe stafi ndihmës akademik i kualifikuar. Motoja e institucionit është “mësojmë duke bërë”. Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. (Takimet dhe vizita në institucion, dokumentacioni për mobilitetin e pedagogëve).

Konkluzione	<i>Kriteret dhe vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet në përputhje me rregulloret e ndryshme të cilat bëhen publike dhe të njohura për studentët. Testimi bëhet në forma të ndryshme në përputhje me rregulloren. Për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies, stafi akademik merr në konsideratë sugjerimet e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e programit të studimit (Ev. D.13.1) përcaktohet qartë sistemi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale. Në nenin 22 të kësaj rregulloreje theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, punës në grup, praktikave mësimore dhe provimit përfundimtar.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni organizon korigjimin e automatizuar të provimeve, si rrjedhojë e bashkëpunimit me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF), në kuadër të projektit Cleanscore (Ev. XXI), çka rrit transparencën në vlerësimin e studentëve.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, (Ev. 2-II; D.13). Vlerësimi i përparimit të studentit kryhet duke përdorur sistemin e notave, ndërsa shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me një sistem prej 10 notash. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, të cilat pastaj konvertohen në nota. Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësim të vazhduar dhe në provim. Në programin mësimor ka lëndë të parashikuara “firma” ku studenti vlerësohet me nota përmes formave të vlerësimit të vazhduar, kolokium, dhe detyrë kursi. Lëndët që në programin e studimit janë të parashikuara si “Provime” zhvillohen në formën e semestrale ose vjetore dhe studenti vlerësohet me provim respektivisht në fund të semestrit ose vitit akademik.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas detyrimeve që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë parakushtet (Ev. D3, rregullore e programit të studimit, neni 27) që lidhen jo vetëm me ndjekjen e procesit mësimor, por dhe me numrin e ECTS-ve etj. që studenti duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi.

	Në rregulloret e institucionit njihet e drejta e studentit për t'u njohur me rezultatin e provimit, madje dhe për tu ankimuar (Rregullore e studimeve në USH, neni 30, pika 4 Takimi me studentët).
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse bëjnë përpjekje për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime (RVB, fq 18). GVJ konstaton se në rregulloren e studimeve të USH dhe të Programit të studimit "Biologji-Kimi", nuk konsiderohet fenomeni i plagjiaturës, si dhe masat që duhet të merren për ta luftuar atë. Në institucion funksionon Kodi i Etikës, që plagjiaturën apo format e tjera të vjedhjes intelektuale (Ev. 12-XII, kodi etikës, neni 8) i konsideron shkelje të rregullave të etikës. GVJ i sugjeron institucionit të rishikojë rregulloret, ku të tregohen mënyrat dhe mjetet që duhet të përdoren për shmangien e plagjiaturës, si dhe masat disiplinore që duhet të merren në raste të tilla.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar. Në rregulloren e USH përcaktohet afati 7 ditë për shpalljen e rezultateve të provimit, përmes postës elektronike, ose përmes një date të caktuar nga pedagogu i lëndës. (Rregullore e studimeve në USH, neni 30, rregullore e programit të studimit neni 29).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi, apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. (Rregullore e studimeve në USH, neni 30, pika 4; Takimi me studentët).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët që kanë ankesa, në ditën e marrjes së rezultatit mund të bëjnë kërkesë me shkrim pranë dekanit të fakultetit përkatës për rivlerësim, kërkesë e cila i dërgohet departamentit përkatës. Departamenti krijon një komision <i>ad hoc</i> , për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës. Pas këtij afati, procesi i vlerësimit të provimit quhet i përfunduar dhe gjenerohet procesverbali dhe askush nuk ka të drejto të ndërhyjë më në sistem për ndryshim rezultatesh (Rregullore e studimeve në USH, neni 30, pika 4)
Konkluzione	<i>Vlerësimi i njohurive bëhet në mënyrë të vazhduar, ashtu siç sanksionohet në rregulloret e USH.</i> <i>USH bën përpjekje për të rritur transparencën në vlerësimin e studentëve, duke përdorur dhe sisteme elektronike të testimit, psh si në rastin e projekti Cleanscore.</i> <i>Vlerësimi u bëhet i ditur studentëve sipas afateve kohore të përcaktuara në rregullore, duke u njohur të drejtën që ata kanë për tu ankimuar.</i> <i>Institucioni konsideron plagjiaturën, apo kopjen në provime si shkelje të etikës, por në rregulloret respektive nuk parashikohen mënyrat e shmangies së këtyre fenomeneve, si dhe masat disiplinore, që duhet të merren në raste të tilla.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVB deklaron se programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin dhe rritjen e njohurive për formimin e specialistëve në fushën e biologjisë dhe kimisë (RVB fq 19). Misioni dhe qëllimi i programit të studimit janë formimi i specialistëve të aftë në fushën e biologji kimisë, përmes integritit të teorisë me praktikën në laborator dhe terren. Studentët mund të thellojnë njohuritë e tyre më tej përmes masterit shkencor në “Biologji mjedisi”, apo Master Profesional në “Mësuesi në Biologji Kimi”. Studentët marrin formim bazë në lëndët shkencore, si dhe formim bazë dhe të avancuar në shkencat dhe metodologjitë në fushat e biologjisë dhe kimisë si: biokimi, mikrobiologji, gjenetikë, biofizikë etj. Volumi që zënë orët e laboratorëve dhe praktikës në terren u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohen gjatë manipulimeve dhe punës së pavarur. (Ev. D.2.1)
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe lëndëve të formimit profesional përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, apo lëndët që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit mjedisor, analizave laboratorike kimike dhe biologjike. Këto lëndë kontribuojnë për të shtuar aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese, për formimin jo vetëm si profesionist por dhe qytetar. (Ev. D.2.1; 3.4; 1.2)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të lëndës, analizohen nga pedagogu kompetencat dhe aftësitë e fituara, të cilat pasqyrohen në relacionet personale të pedagogut, më tej në Departament, ku bëhet analizë e detajuar (Ev. 3.5)
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve	Në programin Bachelor në “Biologji-Kimi” janë angazhuar pedagogë me përvojë në mësimdhënie. Një pjesë e tyre janë emra të njohur në fushat përkatëse. Bazuar në CV e stafit akademik, fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. (CV e stafit akademik, takimet në institucion). Stafit akademik kualifikohet në mënyrë të vazhduar në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies (Ev. V).

<p>inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Një ndër mënyrat që motivon studentët në përvetësimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup, apo puna kërkimore në laboratorët e vetë DBK. Vlen të përmendim Laboratorin mikrobiologjik të qendrës së diagnostikimit mikrobiologji, që forcon njohuritë teorike dhe praktike të studentëve në fushën e mikrobiologjisë (Ev. 3.4). Studentët në seancat e praktikave mësimore dhe në terren, si dhe gjatë seminareve fitojnë aftësi praktike, komunikuese mjaft të mira.</p> <p>Në ambientet e laboratorëve mësimorë procesi praktik është punë në grup dhe në ndonjë rast edhe demonstrativ. Stafii akademik i USH inkurajon edukimin e punës në grup për zgjidhjen e problemeve. Stafii akademik gjithashtu mundohet të kontribuojë në zgjidhjen e nevojave të ndryshme, zgjidhjen e problematikave të cilat janë pjesë e mbledhjeve të departamentit. Departamenti organizon veprimtari të karakterit mësimor edhe shkencor (Ev. 2.6)</p> <p>USH bën përpjekje për të rritur mobilitetet e studentëve (Ev. 2.4). Në dokumentin e vënë në dispozicion (Ev. 2.4) rezultojnë 3 studentë të DBK të cilët kanë kryer mobilitete në dy universitete italiane, por nuk del e qartë se cilit program studimi i përkasin. Në takimin me studentët, GVJ u njoh me një studente e cila i përkiste programit Master Shkencor. GVJ sugjeron DBK të rrisë mobilitetet e studentëve edhe të programit Bachelor, në kuadër të projekteve Erasmus, në të cilat është përfshirë departamenti.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe i ftuar realizon orë të hapura e seminare mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Departamenti organizon aktivitete të ndryshme të karakterit mësimor dhe shkencor, ku mund të përmendim konferencat si 9th International Scientific Conference on Climate Change; Economic Development Environment and People; 5th International Conference “New Perspectives on Global Education, Research and Innovation (https://www.npogeri.com).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit garanton thellimin e njohurive teorike dhe praktike dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve. Këto aftësi e kompetenca që fitohen nga studenti analizohen në fund të lëndës nga pedagogu e më tej nga Departamenti.</i></p> <p><i>Stafii akademik inkurajon debatin dhe diskutimet e studentëve, në mënyrë të veçantë gjatë punëve të pavarura individuale ose në grup siç janë praktikat mësimore, laboratorike dhe në terren.</i></p> <p><i>Stafii akademik i përfshirë në procesin mësimor zhvillon orë të hapura mbi zhvillimet më të reja të teknologjisë brenda strukturës së programit</i></p> <p><i>Institucioni bën përpjekje për të realizuar mobilitete të studentëve në universitete të huaja, kryesisht italiane, por duhet të rritet numri i studentëve Bachelor që përfshihen në mobilitete të tilla.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”, sipas rregullores së programit të studimit mund të mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe/ose punim diplome. <i>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se programi i studimit realisht mbyllet me provim formimi vetëm në fushën e Biologjisë, ose vetëm në fushën e Kimisë.</i></p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, ka një kapitull të veçantë (Ev. D. 13.1, Kreu V, Diplomimi) mbi procedurën e diplomimit ku përcaktohen kushtet që duhet të përmbushë studenti para diplomimit. Në këtë rregullore shkruhet: “<i>Studenti në përfundim të kursit të plotë të studimeve, për të fituar të gjitha kreditet e parashikuara në planin mësimor i nënshtrohet procesit të diplomimit për të fituar titullin sipas emërimit të diplomës. Diplomimi bëhet pasi të jetë plotësuar dhe dorëzuar në sekretarinë mësimore dokumentacioni i paracaktuar në këtë rregullore (neni 35).</i></p> <p>Rregullorja përcakton se të drejtën për të përgatitur diplomë e kanë studentët me notë mesatare jo më poshtë se 8.5 (neni 37), por pavarësisht këtij neni të veçantë studentët e mbyllin programin e studimit me provim formimi, siç u përmend më sipër.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, në nenin 36, jepen detaje mbi procedurën e diplomimit me provim përfundimtar, i cili zhvillohet mbi bazën e një programi të detajuar të miratuar nga Departamenti. Procedura përshkruhet e plotë dhe qartë në rregullore. Institucioni shpall datat e diplomimit dhe i bën ato publike edhe në faqen ëeb të USH.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse informojnë studentët mbi dokumentacionin e detyrueshëm.</p> <p>Stafi akademik mbështet studentët, duke vënë në dispozicion programin e provimit të formimit, fondin e pyetjeve etj. Në rregulloren e programit të studimit (neni 36) përcaktohen qartazi përbërja e komisionit të provimit të formimit, përgatitja e tezave dhe mënyra e realizimit të provimit (Ev. D13.1).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë titullar të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga përgjegjësi i departamentit (në rregullore cilësuar si drejtori i departamentit) dhe miratohen nga Dekani.</p> <p>Teza e provimit hartohet nga komisioni në bazë të fondit të pyetjeve</p>

	<p>dhe përmban pyetje për çështjet kryesore të trajtuara gjatë gjithë programit të studimit. Teza përmban jo më pak se 5 pyetje.</p> <p>Provimi përfundimtar organizohet si edhe provimet e tjera me shkrim të USH (Neni 36) (Ev. 2-II).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit neni 37 përshkruan qartësisht dhe hollësisht procedurën e mbrojtjes me punim diplome. Por punimi i diplomës nuk aplikohet (Takimi me stafin, takimi me studentët).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>USH ka siguruar infrastrukturën, si dhe kapacitetet njerëzore të përshtatshme për realizimin e programit të studimit. Stafi akademik dhe stafi ndihmës akademik, ndihmojnë studentët për kryerjen e matjeve, analizave në seancat laboratorike, apo praktikat në terren. (RVB, fq 21; vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë (Rregullore e programit të studimit, neni 35)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti që ka përfunduar studimet, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Rektori (Ev. D14.2). Në fund të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit (RVB, fq.22).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>USH ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi, kopje të dokumentacionit të studentit dhe siguron informacion për studentin rast pas rasti kur kërkohet. Për këtë përgjegjëse është sekretaria mësimore e cila mban dokumentacionin e studentit dhe e ofron atë në përputhje me kërkesat ligjore. Sekretaria mësimore ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen (Vizita në sekretarinë mësimore).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në rregulloren e programit të studimit specifikohen procedurat e provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimit të diplomës. Në rregullore përcaktohet pragu 8.5 për studentët që mund të realizojnë punim diplome. Megjithatë studentët i mbyllin studimet e tyre me një provim formimi, i cili realizohet në të njëjtën mënyrë si dhe provimet e tjera të lendëve.</i></p> <p><i>Studentët pajisen me një program mbi provimin e formimit, si dhe me</i></p>

	<p><i>një bllok pyetjesh orientuese.</i></p> <p><i>Stafi akademik dhe ai ndihmës mbështesin studentët në kryerjen e matjeve apo analizave gjatë punëve laboratorike, praktikave mësimore dhe në terren.</i></p> <p><i>Studenti në përfundim të studimeve pajiset me suplementin e diplomës, sipas formatit të miratuar nga MASR, si dhe me kopje të plotë zyrtare të programit të studimit.</i></p> <p><i>Dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i vihet në dispozicion rast pas rasti, sipas kërkesave.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik për një program studimi të ciklit të parë Bachelor.</p> <p>Përbërja e personelit akademik, në katër vitet e fundit akademike, paraqitet si në vijim:</p> <p><u>19-20:</u> 16 PAE, me kualifikimin 3 Prof.Dr., 6 Prof.As., 4 Dr. dhe 3 Msc., dhe 8 PAK, me kualifikimin 1 Prof.Dr., 1 Prof.As., 4 Dr., dhe 2 Msc.;</p> <p><u>20-21:</u> 22 PAE, me kualifikimin 3 Prof., 7 Prof.As., 7 Dr., dhe 5 Msc. dhe 5 PAK, me kualifikimin 1 Prof.As., 1 Dr., dhe 3 Msc.;</p> <p><u>21-22:</u> 22 PAE, me kualifikimin 3 Prof., 6 Prof.As., 7 Dr., dhe 6 Msc., dhe 6 PAK, me kualifikimin 1 Prof.As., 2 Dr., dhe 3 Msc.;</p> <p><u>22-23:</u> 20 PAE, me kualifikimin 3 Prof., 5 Prof.As., 7 Dr., dhe 5 Msc., dhe 6 PAK, me kualifikimin 3 Dr., dhe 3 Msc.</p> <p>GVJ evidenton se në të dhënat e paraqitura nga IAL në tabelat 6 dhe</p>

	<p>12 ka mospërputhje dhe pasaktësi, për të cilat saktëson si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vitin akademik 19-21: F.M, PAE tek tabela 6/1, nuk mbulon asnjë lëndë tek tabela 12/1 prandaj nuk është llogaritur; F.H, S.H, V.N, PAK tek tabela 6/1, nuk mbulojnë asnjë lëndë tek tabela 12/1 prandaj nuk janë llogaritur; Në tabelën 12/1, E.H dhe S.K, të cilat nuk janë përfshirë në tabelën 6/1, mbulojnë lëndë në këtë program, prandaj janë llogaritur; S.K, është paraqitur si PAK tek tabela 12/1, por është llogaritur PAE sepse sipas tabelës 6/2 është staf në USH; V.P, e paraqitur si PAK tek tabela 6/1 dhe 12/2 është PAE sepse është staf në USH ndaj është llogaritur si e tillë. - Në vitin akademik 20-21: V.P, Z.T, R.M dhe S.K, paraqitur si PAK tek tabela 6/2 dhe 12/2 janë llogaritur si PAE pasi janë staf në USH. - Në vitin akademik 21-22: V.P, Z.T, R.M, S.K dhe R. B, paraqitur si PAK tek tabela 6/3 dhe 12/3 janë llogaritur si PAE pasi janë staf në USH. - Në vitin akademik 22-23: H.D, PAE tek tabela 6/4 nuk mbulon asnjë lëndë tek tabela 12/4 prandaj nuk është llogaritur; V.P, Z.T, R.M dhe S.K, paraqitur si PAK tek tabela 6/4 dhe 12/4 janë llogaritur si PAE pasi janë staf në USH. <p>Lëndët dhe modulet mbulohen nga staf me eksperiencë në fushat e caktuara. (Ev. 7.1). <i>Vihet re qe ka dhe staf akademik që është titullar lënde, që nuk i përkasin kategorisë “Profesor”, siç e kërkon ligji (Ev. 7.1).</i></p> <p><i>Numri i orëve i realizuar nga stafi i Departamentit të Biologjisë, USH, nuk është në përputhje me Udhëzimin e MAS për orët në auditor, ku 8 nga 10 pedagogë kanë 203-215 orë më tepër se orët e lejuara në udhëzim.</i></p> <p>I gjithë dokumentacioni i çdo punonjësi ruhet në arkivën e Sektorit të Burimeve Njerëzore. Dosjet e personelit përditësohen vazhdimisht me aktivitetet të reja të stafit, rezultate të kërkimit apo kualifikime.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit (Ev. XXIV) dhe takimit në institucion, vihet re qe, personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi.</p> <p>Në 4 vitet e fundit akademike, ngarkesa paraqitet si në vijim:</p> <p>19-20: 80.4 % PAE / 19.6 % PAK; 20-21: 88.5 % PAE / 11.5 % PAK; 21-22: 89.3 % PAE / 10.7 % PAK; 22-23: 87.4 % PAE / 12.6 % PAK.</p>
	<p>GVJ saktëson se për paraqitjen e këtyre të dhënave janë marrë në konsideratë të dhënat e tabelave 12/1, 12/2, 12/3 dhe 12/4 të tabelave</p>



	përmbledhëse, ku për shkak të mospërputhjeve / pasaktësive të të dhënave, llogaritja është realizuar duke reflektuar sa më lart detajuar në kriterin 1.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Qëndrueshmëria e personelit akademik deritashme, nuk është e kërcënuar nga largimet e vazhdueshme për shkak të emigracionit (pyetje specifike e GVJ gjatë vizitës në institucion). USH “Luigj Gurakuqi” ndjek politika për të qënë konkures dhe tërheqës si IAL për burime njerëzore cilësore, duke investuar në rritjen profesionale gjatë viteve. Si IAL ka qëndrueshmëri në staf akademik me kohë të plotë. Punësimi i personelit në USH respekton kërkesat e Kodit të Punës, me kontrata individuale punësimi dhe mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (Ev. 4.1, 4.2, Ev. 4.3).
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	USH në përputhje me nje rregullore te brendshme te institucionit, (Ev. XI) si dhe me afatet kohore ngre komisionet e vlerësimit në departament dhe e përcjell në Dekanat, e më pas në Rektorat (Ev. 4.4). Komisioni i departamentit bën vlerësimin e aplikantëve në përputhje me kriteret e shpallura, shqyrton dosjen e aplikimit sipas formularit të vlerësimit dhe harton listën e kandidaturave, sipas pikëve të grumbulluara, në rendin zbritës për çdo kandidat së bashku me pikët e intervistës. Njoftimi online behet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ndërsa procedura tjetër monitorohet dhe menaxhohet nga NJSBC). Kandidatët njoftohen nga NJSBC me email për pikët e grumbulluara dhe rankimin e tyre.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	USH garanton mbarëvajtjen e praktikave mësimore (laboratore) në ambiente adekuate dhe me personelin e duhur akademik dhe ndihmës akademik, ku përmendim që edhe personeli ndihmës është i kualifikuar me ciklin e dytë të studimit (Ev. XI, Ev, 7.4).
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se USH, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër, si dhe dosjen personale për staf jo akademik. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësimet në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore si dhe kualifikimet e tyre. Gjithashtu GVJ evidentoi që çdo fund viti akademik, pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit

	<p>evidencat e realizimit te ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky i koordinuar nga Drejtuesi i Departamentit. Të dhënat përfshijnë listat e personelit të angazhuar për çdo semestër dhe vit akademik, në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Sikurse është cituar dhe më lart në kriterin 1, standardi IV, ngarkesa mësimore e stafit të brendshëm kalon normat e vendosura nga udhëzimet e MAS.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, u morën dokumenta shtesë për V.P, e cila ka qenë e punësuar në USH si staf administrativ, fillimisht specialiste në sektorin e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve, dhe më pas emëruar Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Kërkimit Shkencor, Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Projekteve, e cila gjithashtu ka kontratë me kohë të pjesshme me USH si lektore për vitin akademik 22-23 në Departamentin e Biologji-Kimisë, USH.</p> <p>(Ev. XI; Dokumenta shtesë gjatë vizitës)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nuk ka shumë marrëveshje midis USH me IAL të tjera publike dhe private. Vetë departamenti ka në dispozicion stafin e mjaftueshëm për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikat profesionale (Ev.51 L.I, Ev.1.2). <i>GVJ gjykon se mungesa e tezave të diplomave dhe zëvendësimi i plotë me provim, bën që të ketë mungesë të temave studimore me bazë eksperimentale, që u duhen dhënë përparësi.</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Stafi akademik mbikqyrës angazhohet dhe kontribuon në mënyrë aktive në plotësimin e praktikës profesionale të studentit, duke u angazhuar edhe në pasurimin e Muzeut të FSHN, USH, apo dhe për biodiversitetin. Në këto përfshihen dhe stafi ndihmës, i cili jep kontribut në këtë drejtim (Vizita në institucion).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për një program studimi të ciklit të parë Bachelor.</i></p> <p><i>Ka qëndrueshmëri personeli, gjë që reflektohet në kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</i></p> <p><i>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi, por në më të shumtën e personelit efektiv e kalojnë limitin e vendosur në udhëzim.</i></p> <p><i>Procesi i rekrutimit bëhet sipas ligjit, Statutit, etj.</i></p>

	<i>GVJ rekomandon që stafi akademik që është titullar lënde, të jetë i kategorisë "Profesor", siç e kërkon ligji, si dhe të ketë më tepër bashkëpunime kërkimore gjë që do të rrjedhin dhe nga realizimi i diplomave, me drejtim kërkim-eksperiment, dhe jo vetëm provim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore. në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	USH kryen dhe zhvillon veprimtarinë akademike dhe administrative në mjedis të përshtatshëm për pjesën administrative, atë akademike dhe atë mbështetëse, sipas natyrës specifike të moduleve përkatëse (Ev. 7.0) . Mjediset janë ekskluzivisht të dedikuara për aktivitete specifike. (Vizita në Institucion) .
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	USH disponon infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij. Ambientet e fakulteteve (salla leksionesh e seminaresh, laboratorë didaktikë mësimorë) janë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor-shkencor për studentët dhe personelin akademik. Sipërfaqet në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë (Ev. XX; Vizita në Institucion) .
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në nivel programi studimi të gjithë laboratorët mësimorë dhe kërkimorë, ku zhvillohen orët laboratorike, janë të pajisur dhe plotësuar me mjete mësimore, aparatura dhe reagentë në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit (Ev. 4.5; Vizita në Institucion) .
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	USH ka një laborator të informatikës të pajisur me kompjutera, ka veprimtari interaktive dhe akses në programe dhe databaza specifike në dispozicion të studentëve dhe stafit. (Vizita në Institucion) .
Konkluzione	<i>Duke u bazuar në evidencat në dispozicion dhe vizitën në Institucion, GVJ konkludon se mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e laboratoreve dhe veprimtarive të tjera praktike.</i>

	USH ka një laborator të informatikës të pajisur me kompjutera, ka veprimtari interaktive, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale janë të garantuara për mbarëvajtjen e programit të studimit (Ev. D.2.2). Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe italiane, si dhe leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë program studimi, si dhe nga vizita në Institucion vuri re se në bibliotekë janë librat kryesorë të lëndëve. Materialet janë si për të mbuluar pjesën e lëndëve bazë, ashtu edhe për ato të lëndëve profesionale. Pjesa më e madhe e librave të specialitetit, janë të vëna në dispozicion në bibliotekën online, ku gjenden libra në gjuhën angleze, italiane dhe gjermane.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Çdo vit USH pasuron titujt e bibliotekës. Librat që shërbejnë për plotësimin e fondit të Biologji-Kimisë, FSHN, USH, (Ev.4.6) porositen e shfrytëzohen nga stafi i departamentit e studentët. GVJ konstaton se <i>përditësimet në literaturë duhet të jenë realizuar më mirë për lëndët e programit të biologji-kimisë, pasi nuk u konstatua përditësime gjatë 5 viteve të fundit.</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, me 3 salla e 300 vende. Të gjithë studentet mund të punojnë në salla, me titujt që posedon biblioteka (https://bush.unishk.edu.al/), Studentët në 26 poste, kanë akses dhe on-line për gjetjen e titujve bashkëkohore të ndryshme. (Vizita në Institucion).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e USH ka fond fizik 8782 tituj si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Literatura fizike ka 164 tituj për kimi dhe 502 në biologji, që garanton mbulimin e moduleve dhe veprimtarisë specifike të programit (Ev 4.7). Bashkëpunimet me IAL ndërkombëtare duhet t'u kërkohej edhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

33

	donacioni me literaturë për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës në USH.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë për gjithë studentët dhe stafin. (Evd. https://ulibrary.rash.al/).
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. USH ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Kapacitet e bibliotekës ofrojnë kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi aksesimi në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit “Biologji Kimi”, për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektet e tyre. Nga ana tjetër të gjitha punimet, materialet didaktike, librat universitar duhet të depozitohen në bibliotekë, duke e pasuruar më shumë atë (Vizita në Institucion).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ka orare të përcaktuara për studentët. Oraret ishin të afishuara në bibliotekë. Studentët kanë mundësi aksesimi në bibliotekë edhe ditët e shtuna. <i>GVJ sugjeron se biblioteka duhet të ofrojë orare ekstra gjatë kohës së sezoneve të provimeve.</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (tituj kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Departamenti ndjek cilësinë e programit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe online nga personeli akademik dhe studentët dhe mat efektivitetin dhe nevojën e pasurimit të vazhdueshëm të fondit me sugjerime të stafit akademik për nevoja që ato kanë për literaturë. (Ev. XXVI, Ev.XXVIII)
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale sigurojnë mbarëvajtjen e programit të studimit. GVJ konstaton se më shumë vëmendje i duhet dedikuar përditësimit të literaturës, e cila duhet të realizohet në mënyrë periodike nga titullarët e lëndëve. Biblioteka dhe njësitë e tjera përgjegjëse duhet të ndjekin sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online dhe cilat janë kërkesat për tituj. Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>USH disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Të gjitha të dhënat e studentëve dhe dokumentacioni i tyre, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, dhe këto administrohen nga sekretaria mësimore e IAL, sipas një procedure të miratuar, sipas Programit Pitagora (Ev. XXIII), ndërsa Programi SMAK (Ev. XXIV), është për administrimin e gjithë dokumentacionit financiar dhe mësimor.</p> <p>Gjithashtu, USH ka databazë për ruajtjen në formatin elektronik të të dhënave të studentëve, që fillojnë me gjeneralitetet e tij, dokumentacioni i shkollës së mesme, data e regjistrimit, programi i studimit, matrikullimi, numri i telefonit, e-maili, nr. ID, gjendja civile, vendlindja, vendbanimi, foto e studentit, pagesat, etj). (Vizita në Institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni i stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në IAL. Dokumentacioni arshivohet dhe ruhet në arkivën e IAL. (Ev. XXXIV; Ev. XXXV)</p> <p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>I gjithë dokumentacioni administrohet sipas një procedure standarde. (Ev. XXI, XXII, XXIII)</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Stafi akademik përveç komunikimit me grupet mësimore, përdor dhe platforma të edukimit si TEAMS etj., me anën e të cilave shkëmbehen informacione dhe materiale me studentët (Evd. XX).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese (Ev. 4.5).</p>

dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.									
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja eeb e USH, http://unishk.edu.al/ jep gjithë informacionin e detajuar për programin e studimit, stafin akademik përgjegjës, aktivitete etj., <i>vetëm ne gjuhën shqipe. Institucioni duhet të ofrojë këtë informacion edhe në gjuhën angleze.</i>								
Konkluzione	<i>IAL disponon sistem të menaxhimit, programin Pitagora dhe programin SMAK, nëpërmjet të cilëve administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Faqja web e USH, jep gjithë informacionin e detajuar për programin e studimit, stafin akademik përgjegjës, aktivitete etj., por duhet të jetë edhe në anglisht, jo vetëm në gjuhën shqipe.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	USH harton çdo vit raportin financiar i cili realizohet nga zyra e financës së IAL. Institucioni harton një raport financiar të kostove për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Gjithashtu, Bordi i Administrimit miraton fond të veçantë për mbështetjen e aktivitetëve të studentëve, apo për aktivitete kërkimore shkencore të stafit. (Ev. XVIII; Ev. 4.8)
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Zyra e financës administron gjithë dokumentacionin financiar lidhur me këtë kriter. Plani i financimit për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit. (Ev.4.8).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	USH kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Zyra e financës administron gjithë dokumentacionin financiar lidhur me këtë kriter.

	(Vendimi i BA nr. 42, datë 14.02.2022)			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	<i>Departamenti nuk zotëron buxhet të veçantë dhe nuk ka raporte financiare sepse USH e ka të përqëndruar financën dhe në raportin vjetor financiar, USH paraqet të dhëna mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. (Ev. XVIII; Ev. 4.8)</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Suksesi i vazhdueshëm në menaxhimin, drejtimin dhe diplomimin, tregon për një qëndrueshmëri institucionale dhe financiare por, më shumë duhet bërë për të arritur cilesinë që studentët e BE e kanë të garantuar. Institucioni ka planifikuar në mënyrë adekuate kërkesat për fonde nga granti i Qeverisë apo burime të tjera, dhe deritashmë nuk ka pasur vështirësi të papritura për mungesë fondesh, pasi parashikimet janë bërë në kohë dhe kanë përfshirë nevojat e strukturave të tij. (Ev. XVIII)			
Konkluzione	<i>USH garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ rekomandon përcaktimin e një buxheti të detajuar në rang njësie Bazë, si p.sh., për Departamentin e Biologji-kimisë, dhe jo vetëm buxhetin e FSHN, USH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore, kanë hartuar Statutin dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Statutin e USH, rregulloret e FSHN, rregulloren e Departamentit të Biologji-Kimisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion

	<p>përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta.</p> <p>Procedura e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Biologji-Kimi”, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS). Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit.</p> <p>(Ev. 117; Ev. 118; Ev.119)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Numri i kuotave (Ev 5.1) dhe kushtet e pranimit, janë të përcaktuara sipas kriterëve të parashtruara nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, që bën politikat e listave për kuotat. Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për student (Ev 5.3). Fituesit në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Biologji-Kimi” kanë pasur mundësinë të regjistrohesh online (Ev. D.6.2) në këtë program studimi, duke respektuar raundet e regjistrimit në portal dhe në momentin që kanë rezultuar fitues, kanë dorëzuar pranë sekretarisë mësimore dokumentet që lidhen me pagesën e tarifës së regjistrimit dhe dokumentacionin përkatës për regjistrim.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në USH, bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vitit akademik. Departamenti merr pjesë në hartimin përpara çdo viti akademik të kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Ato dërgohen në QSHA dhe MAS, si dhe publikohen në faqen e USH (Ev. D.6.1)</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në programet e ciklit të parë, kriteri i përgjithshëm i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me VKM. Kandidati duhet të këtë përfunduar arsimin e mesëm në brenda ose jashtë vendit. Diploma e arsimit të mesëm, e marrë në një shtet të huaj duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse e MAS. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme, pasi gjenden në faqen e ëeb-it të USH, si dhe në Rregulloren e përgjithshme të USH. Politikat e pranimit të studentëve parashikohen edhe në programin e studimit (VKM 436, dt. 30.06.2020).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti</p>	<p>USH, çdo fillim viti organizon takime me maturantët e shkollave të</p>

akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	mesme, për ti informuar ata lidhur me programet e studimit, kriteret e hyrjes dhe tarifat e studimit. Në çdo fillim viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Informacioni është i aksesueshëm në faqen e USH (Ev. D.18).			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Para fillimit të vitit akademik USH parashikon kriteret dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara (komuniteti rom dhe egjiptian) (Ev. 5.4). Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara janë në përputhje me Udhëzimin nr. 17, datë 30.07.2019.			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	USH në rregulloren e programit ka parashikuar kriteret për pranimin e studentëve të huaj. Pranimi i studentëve të huaj bëhet me konkurim të organizuar nga USH. Studenti i huaj duhet të zotërojë njohjen e gjuhës shqipe, e vërtetuar përmes testeve kombëtare (Udhëzues 17, dt 30.7.2019).			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	USH ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta të studentëve, si komuniteti rom dhe egjiptian, studentët me aftësi të kufizuara apo studentët me prind me aftësi të kufizuara, duke parashikuar kuota pranimi në programet e studimit sipas kategorive të veçanta, si dhe duke ofruar bursa studimi në bazë të udhëzimit nr. 17, datë 30.07.2019. (Ev. D20)			
Konkluzione	GVJ vlerëson se USH siguron harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. Pranimi i kandidatëve të rinj, bëhet në përputhje me kriteret e pranimi dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vitit akademik. FSHN organizon takime me maurantët e shkollave të mesme, për ti informuar ata lidhur me programet e studimit. USH parashikon kriteret dhe kuota për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara, apo dhe të atyre nga trojet			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në	Informacioni në lidhje me kriteret e përparimit akademik të

dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	studentëve është i publikuar nëpërmjet akteve rregullatore institucionale, por edhe nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në ëeb-in e USH. Vlerësimi realizohet përmes nje klasifikimi sistematik, sipas nje plani dhe nje metode te caktuar, i rregullt dhe transparent, i vazhdueshëm dhe i mirëorganizuar, i cili përkufizohet si kontroll sistematik i vlerësimit të dijeve dhe i shlyerjes së detyrimeve të mbartura nga studenti, që synohen nga vetë programi (RVB fq. 33), (Ev. II, Ev.III).			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatore, procedura të miratuara e të bëra publike (Udhëzues nr. 17, dt. 30.07.2019). Normalisht Komisioni Ad-hoc i ngritur nga departamenti, ben vlerësimin e dokumenteve te paraqitura nga studentët e interesuar për të transferuar studimet, por deri tani nuk ka patur raste transferimi.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në lidhje me mënyrën e vlerësimit studentët informohen në orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi, rregullore dhe mbarëvajtje provimi (Takim ne institucion). Sqarohen pikët, mënyra e vlerësimit, nota kaluese, rregullat e hyrjes ne provim dhe mbarëvajtjes së provimeve (Ev. 1.1).			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni jep informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së diplomimit, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj (Ev. D.1, Ev.D.3, Ev. D.14.1). Në fushen e studimit Biologji-Kimi nuk aplikohet diploma, por vetëm provimi.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Çdo fillim viti akademik USH harton kalendarin përkatës dhe organizon vizita nëpër shkollat e mesme me nxënësit maturantë për t`i njohur ata me programet e studimit që ofron IAL. Kalendar i përcillet për dijeni Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar. Zyra e Zhvillimit të Karrierës në USH organizon takime me maturantët për programet e studimit të USH-it, shpërndan postera, përgjigjet për pyetjet që kanë të interesuarit (Ev. III, Ev. XIII). Spotet publicitare janë gjithashtu një praktikë që USH ndjek.			
Konkluzione	GVJ konstaton se USH vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit, <i>vetëm përmes përgjegjësit të departamentit dhe strukturave të tjera drejtuese</i> . Këto takime pasqyrohen edhe në rrjetet sociale, (https://facebook.com/departamenti Biologji-kimi) në varësi të menaxhimit, qoftë si fakultet apo dhe departamenti. (Ev. D.3).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Përveç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të lëndës: zhvillimin e mësimin në auditor në formën e leksioneve apo seminareve, tipologjinë e ushtrimeve; format e kontrollit të vazhdueshëm, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje për provime, përgatitje e provimit të diplomës, etj. (Ev. D3).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në nivel fakulteti apo universiteti, studentët informohen për aspekte, për të cilin ata janë të interesuar si p.sh. mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës (Ev. 6.1) . Studentët bëhen pjesë e panairove dhe ëorkshop-eve të organizuara nga universiteti, duke marrë informacionet e nevojshme për mundësitë që ofron tregu aktual i punës.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative të cilat janë të publikuara në formë dixhitale, në dispozicion të studentëve. Në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij (Ev. 6.4) . Në faqen ëeb të Universitetit, në rubrikën studentët, gjenden informacionet e nevojshme për studentët, që aktualisht ndjekin studimet dhe për studentët e ardhshëm (RVB fq.36)
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në nivel programi studimi është përgjegjësi i departamentit për t'i asistuar studentët në problematika të ndryshme por dhe për ti informuar në lidhje me aktet rregullative dhe elementë të detajuar të programit të studimit. Përmes platformave ESSE (Ev. XXI) dhe Platforma Pitagora (Ev. XXII) , studentët perftojnë informacione dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me mbarëvajtjen e komunikimit të brendshëm, informacionit dhe dokumentacionit, i cili është lehtësisht i arritshëm nga studentë në distancë.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se studentët informohen për strukturën, organizimin</i>


	<p>dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit.</p> <p>Studentët informohen mbi mundësitë e mobilitetit.</p> <p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative.</p> <p>GVJ rekomandon që për programet e lëndëve, syllabuset, apo vlerësimin, etj. të gjenden edhe rrugë të tjera informimi, dhe jo vetëm përmes përgjegjësit të departamentit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në USH arkiva përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve, që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive mësimore të secilit fakultet (Ev. 5.5, Tab .23). Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin e diplomave të lëshuara për programin e Ciklit të Parë Biologji-Kimi.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaritë mbajnë regjistrin e regjistrimeve për programin e studimit Biologji-Kimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhëra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, etj. Në sekretarinë e FSHN-së ruhen listat e plota të studentëve që nuk kanë përfunduar me sukses programin e studimit. Këto të dhëna disponohen në variantin elektronik dhe në atë të shkruar. Në programin Biologji-Kimi, për vitet akademike 2019-2020 e në vazhdim, nuk ka patur të tërhequr nga programi i studimit Biologji-Kimi (RVB fq.37; Vizita në Institucion).
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve të programit Biologji-Kimi, FSHN, USH, menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të gjitha të dhënat e studentëve administrohen nga sekretaria mësimore e USH (Ev. XXII). Autorizimi i të dhënave jepet nga titullari i institucionit, në përputhje me rregulloren perkatëse.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin	Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave

(sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe (Takim në institucion). Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme. USH dhe Departamenti realizon kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin sipas akteve të nxjerra nga USH, (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), dhe vlerëson saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti Biologji-Kimi, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit të Karrierës harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve (Ev. 5.6, Tab 21).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se USH disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Sekretaria mësimore ka të dhëna për çdo student në variantin elektronik dhe në atë të shkruar. USH dhe Departamenti realizojnë kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin sipas akteve të nxjerra nga USH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Përfaqësimi i studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të USH është garantuar në Statut (Ev. I) dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, Bordi i Administrimit, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, apo mund të marrin pjesë në mbledhjet e departamentit I herë në muaj të cilat janë të hapura për studentët. (Takim në institucion; Ev.5.24)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe	Këshilli studentor është organ kolegjial përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe përveçse një detyrim ligjor është edhe një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. (Ev. XXXII; Ev. XXXIII)

Hoto



me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.									
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Ndër strukturat pjesë e USH në përmirësimin e programit të studimit janë edhe Studentët aktualë në programin e studimit, të cilët japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e studimit. Ata janë të ftuar në gjithë diskutimet në nivel programi studimi. Ata mund të përcjellin mendimet e tyre jo vetëm në Dekanat, por edhe në hallkën më të lartë të miratimit të planeve mësimore, Senatit Akademik, ku njëri prej anëtarëve është përfaqësues nga studentët (Ev. 3.2, Ev.D.20).								
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. USH ka të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit. Çdo provim parashikon edhe ditën e dhënies së rezultatit individualisht ku studenti ka të drejtën edhe të ankimimit. (Ev D.15).								
Konkluzione	<i>GVJ kriterëve se studentët përfshihen në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre, përmes përfaqësimit të tyre në Senatit Akademik, Bordin e Administrimit, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, etj.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	USH ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t e cila është në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Veprimtaria e zyrës së këshillimit të karrierës, sipas edhe Statutit (Ev.I), orientohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre që në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. (Ev.5.8).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Këshillimit të Karrierës ka ngritur një sistem të posaçëm informimi, ajo përditëson studentët me informacion të hollësishëm mbi mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime profesionale, forume rinore, aplikimet e mundshme në konferencat vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, etj. (Ev. D.20).

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>USH në bashkëpunim me Zyrën e KSGC organizon aktivitetet e përgjithshme dhe të ndara sipas programeve të studimit për njohjen e studentëve me universitetin, pedagogët, mjediset, rregulloret, të drejtat dhe detyrimet e studentit. Zyra për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. (Takimi në institucion; Ev. XV)</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Institucioni lehtëson punësimin e studentëve të tij edhe brenda IAL, por edhe me punëdhënës të ndryshëm. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. Nëpërmjet regjistrimit të të dhënave të studentit: si CV- ja, programi i studimit, rezultatet e karrierës universitare, eksperiencat e ndryshme, certifikimi i gjuhëve të huaja, fushat e interesit profesional, shërbejnë për të krijuar lidhjen me punëdhënësin, i cili ka të dhënat e mjaftueshme për t'u interesuar. Krijimi i bazës së të dhënave është detyrë e alumnit, ku tashmë vepron që nga viti 2017 e në vazhdim (RVB fq 39).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>USH ka Zyren e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t e cila është në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës ka ngritur një sistem të posaçëm informimi, ajo përditëson studentët me informacion. Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës, por bashkëpunimin me Alumni duhet ta bëjë më mirë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	USH harton udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies si zhvillimit të mësimi online për shkak të pandemisë COVID-19, si dhe përdorimin e sistemit Teams, apo dhe të tjera, në përputhje me Sigurimin e Cilësisë, brenda kuadrit ligjor të lejuar. (Ev. I, Ev. D.3).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike afësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	USH ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, ose KGSC, e cila është strukturë që krijohet me vendim senati dhe me mision monitorimin e sigurimit të cilësisë në USH, dhe në njësitë kryesore të saj, për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit (Ev. XIV) dhe çdo vit miraton një plan pune (Ev 6.). NJSBC, pasi bën vetëvlerësimin, në përfundim të vitit akademik harton raportin vjetor të cilin ia paraqet rektorit, së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i NJSBC-së hartohet bazuar në anketimet e vazhdueshme të studentëve dhe në rezultatat e monitorimit të kryera nga Njësia gjatë vitit akademik. Departamenti inkurajon kualifikimin e personelit akademik në fushën e mësimdhënies dhe në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies (Ev. 2.1, Ev 6.2).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet anketimeve dhe pyetësorëve që plotësohen nga studentët në mënyrë anonime. Çdo vit nga NJSBC përfshihen nëpërmjet pyetësorit të gjithë studentët të cilët shprehin mendimet e tyre në mënyrë të lirë dhe vullnetare (Ev. 3.2, VKM Nr.41, date 24.1.2018, Ev. D.15).
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm në faqen eeb të USH. NJSBC-ja e zhvillon veprimtarinë sipas rregullores (Ev. 6.2). Në mënyrë periodike NJSBC-ja informon rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen (Ev. 3.2).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, (Ev. 6.1), që adresojnë dhe synojnë përmirësimin pikave të dobëta të evidentuara. Shembull praktik është plani i masave që lidhet me realizimin e detyrave të planifikuara.
Konkluzione	<i>USH ka hartuar udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, të cilat janë bashkëkohore.</i>

	<p><i>Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, ose KGSC, zhvillon mekanizma të monitorimit dhe vlerëson në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse.</i></p> <p><i>NJSBC-ja informon rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në zbatim të ligjit ligjin për arsimin e lartë LAL 80/2015, neni 103, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), USH implementon dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë (Ev. 6.1, Ev. 6.2, Ev. D.3). Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies (Ev 1.1).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në USH funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kodin e cilësisë (Ev. XV, Ev. 6.2). NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore. Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshëm bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës, plotësimi i së cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboratoreve, respektimi i orarit të mësimi, udhëheqjet për detyra kursi apo tema diplome. Paralelisht edhe titullarët e lëndëve plotësojnë formularët e performancës për stafin me kohë të pjesshme që ata aktivizojnë në lëndët përkatëse i cili merret parasysh në procesin e rekrutimit të tyre në vitin akademik pasardhës. Ndërsa bashkëpunëtorët e jashtëm janë të përfshirë në vlerësimin e performancës, studentët nuk janë të përfshirë në këtë proces. (Ev. XV; Ev. 6.3)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe</p>

<p>jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL. USH, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes, dhe cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si, sondazhe e intervista të studentëve. (Ev. XVI) Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të anketuarit përpunohen nga NJSBC dhe i paraqiten autoriteteve drejtuese në IAL për njohje dhe vlerësim.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, USH ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja. Treguesit e performancës përfshijnë tregues të tillë si: niveli i regjistrimeve, niveli kalueshmërisë, niveli i diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. NJSBC përpiket për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë standardizuar si procese që kryhen si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron përmes KGSC (Ev. XV), janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC (Ev. 6.2) dhe në aktet rregullatore të institucionit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional.</i></p> <p><i>NJSBC kryen monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë të standartizuara si procese që kryhen në mënyrë periodike, si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</i></p> <p><i>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, USH ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Koordinatori i programit të studimit është personi përgjegjës i cili ndjek dhe monitoron ecurinë e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në Departamente dhe Dekanat, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit. Programi i studimit përmirësohet duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe studentët. Pas anketimit me studentët, bëhet rivlerësimi në nivel departamenti dhe më pas nga Senati i USH-së (Ev. 3.2). Përgjegjësi i departamentit, dekani ndjekin dhe vlerësojnë orët e mësimit për stafin akademik të kategorisë “Lektor” dhe “Asistent Lektor”. Ky proces përfundon me hartimin e një raporti vlerësimi (Ev. 6.4).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Ndërkohë, në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre (Ev. 6.5). Pjesë të kësaj analize janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmblyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim. (Ev. 6.5)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamentet e FSHN në USH analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numri i studentëve frekuentues; - Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikave; - Plotësimi i standardeve të grupeve mësimore; - Plotësimi i standardeve të stafit akademik; - Plotësimi i standardeve të didaktikës dhe laboratorëve; - Kalueshmëria dhe cilësia semestrale; - Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale; - Numri i të diplomuarve; - Konkluzionet e pyetësorit të studentëve (Ev. 3.2, Ev. 6.5).
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të</p>	<p>USH në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të tërthorta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Departamenti, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p>

<p>diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>cilësisë së programit të studimit përdor mënyra të tjera vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (ALUMNI), të personelit akademik, ndihmës-akademik, që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program. USH merr pjesë gjithashtu në zhvillimin e sondazheve në nivel kombëtar, që zhvillohen nga ASCAL. Për këtë qëllim IAL ngre grup pune, i cili asiston studentët në orientimin e procesit të sondazheve, si dhe u krijon mundësi që në anonimanitet të plotë të plotësojnë pyetësorët. (Takim ne institucion; Ev. D. 16)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>USH monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, duke garantuar arritja e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p> <p><i>procesin e përditësimit të programeve.</i></p> <p><i>USH përdor mekanizma e proçese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit.</i></p> <p><i>Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Të dhënat e vlerësimit të programeve të studimit përfshihen në raportet vjetore të USH. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit, hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet KSGC, përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi si nr. e studentëve të licensuar, të punësuar etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>IAL nëpërmjet NJSBC garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit (Ev. D.16). Detyrat dhe funksionimi i NJSBC në IAL janë të përcaktuara në Rregulloren e NJSBC (Ev. 6.2). Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të USH, përfshihen politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me konventën europiane, planin e ndërkombëtarizimit të</p>

	<p>USH, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare në mënyrë që programi i studimit të njihet sa më lehtë në vendet e huaja dhe/ose realizimin e diplomave të dyfishta. Në funksion të këtij qëllimi, prioritare mbetet zhvillimi i programeve mësimore, rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve nga Kosova e Mali i Zi. Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor, do realizohen nëpërmjet zhvillimit të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve. Për përmirësimin e vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit, institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në hartimin e politikave të zhvillimit strategjik dhe në politikat e ndërmarra për ndërkombëtarizimin e programit të studimit (Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Detyrat konkrete të NJSBC parashikohen në rregulloren së NJSBC, ku vlerësimi i programeve të studimit dhe personelit akademik bazohet në disa kriterë. FSHN ka miratuar rregulloren e NJSBC në nivel fakulteti dhe ka ngritur grupin e punës për Sondazhin kombëtar të studentëve (Ev. 6.2, Ev. 6.3)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo miratohet me vendim të SA dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët pesë janë përfaqësues të personelit akademik, një përfaqësues i Këshillit Studentor dhe një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, sigurimi i cilësisë në USH inicion në nivel Njësie Bazë me ngritjen e grupeve ad-hoc të cilët merren me çështje si, rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, vlerësimi i programit të studimit dhe çështje të tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit mësimor e kërkimor shkencor. Në grup futen dhe përfaqësuesi i studentëve të cilët janë në vitin e fundit të studimit (Ev. X, Ev. 2.1).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Vlerësimi i studentëve dhe stafit akademik bëhet mbi bazën e meritokracisë, në bazë të manualit të cilësisë (Ev. X) Në përzgjedhjen e anëtarëve në proceset ciklike të vlerësimit janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperiencia të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese. (Ev. 2.1).</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin</p>	<p>NJSBC në përbërje të saj ka një ekspert të jashtëm, i cili jep kontribut në hartimin e pyetësorëve dhe përpunimin e raporteve të kësaj strukture (Ev. 6.2). Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit është</p>

e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	përfshirë dhe një ekspert i jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon. Në procesin e vlerësimit institucioni realizon takime me ish studentë të diplomuar, Biokimiste specialistë, ekspertë të fushës, të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efikase me kërkesat e tregut të punës.			
Konkluzione	<p><i>IAL nëpërmjet NJSBC garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>Sigurimi i cilësisë në USH nis në nivel Njësie Bazë, me ngritjen e grupeve ad-hoc, të cilët merren me çështje si rishikimi dhe përditësimi i syllabuseve dhe kurrikulave, etj.</i></p> <p><i>Vlerësimi i studentëve dhe stafit akademik bëhet mbi bazën e meritokracisë, në bazë të manualit të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike në faqen zyrtare të USH, fton studentët dhe stafin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet, përmes Planit të punës së KGSC (Ev. 6.1)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	IAL në përfundim të çdo viti akademik publikon raportin vjetor të cilësisë, i cili hartohet nga struktura e NJSBC brenda institucionit (Ev. 6.2). Bëhet kujdes me të dhënat sensitive, duke ruajtur etikën dhe lirinë akademike, brenda kuadrit ligjor të lejuar.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Përveç informimit dhe publikimit të rezultateve që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, një aspekt mjaft i rëndësishëm është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse. Në përgjithësi, pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna, si dhe është menduar të ketë trajnime në fushën e mësimdhënies (Takim në institucion; Ev. D.8; Ev.1.3).
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>personelit akademik, administrativ dhe studentët. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se FSHN dhe Departamenti i Biologji-Kimisë, kanë zhvilluar një sërë aktivitete me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre për zgjidhjen e situatave të ndryshme në praktikë, aktivitetet kërkimore-shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Vlen të theksohet dhe mbështetja e institucionit për stafin akademik, për rritjen e tyre profesionale, si pjesmarrjen në aktivitete shkencore apo mbështetje financiare për botime në revista me faktor impakti (Takimi me stafin akademik, RVB; Ev.D.12).</p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit (Ev. II, Ev. 6.3).			
Konkluzione	<i>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Biologji-Kimi, janë publike, transparente dhe efektive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Biologji-Kimi”, të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Pika të forta dhe afirmime:

1. Institucioni ka një historik të gjatë në ofrimin e programeve të studimit, duke ruajtur dhe konsoliduar vlerat kombëtare dhe akademike.
2. Institucioni disponon infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programeve të studimit, duke përfshirë stafin akademik të kualifikuar dhe laboratorë të pajisur mirë, si Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolf Dieter Sixl”, e cila ofron shërbime edhe për të tretët dhe shërben njëkohësisht si laborator reference për Qarkun e Shkodrës, apo laborator i trajnimit të vazhdueshëm për trajnimin e vazhduar të stafit akademik me metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

Pika të dobëta:

1. Provimi i formimit për studentët realizohet i ndarë vetëm në Biologji, ose vetëm në Kimi, pavarësisht se programi i studimit zhvillohet i plotë në të dy fushat njëkohësisht (**Standardi II.1, kriteri 1 dhe 4; Standardi III.5, kriteri 1**).
2. Në rregulloren e programit të studimit nuk përfshihen objektivat formuese të programit të studimit, si dhe kompetencat që synohen të arrihen përmes këtij programi, të cilat citohen vetëm në analizën e punës mësimore kërkimore (**Standardi II.4, kriteri 6**).
3. Numri i kufizuar i marrëveshjeve të bashkëpunimit për formimin praktik të studentëve dhe mungesa e raporteve analitike mbi impaktin e bashkëpunimit me institucione të ndryshme në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit të studimit (**Standardi I.2, kriteri 3 dhe 4; Standardi II.5, kriteri 3**).
4. Disa prej titullarëve të lëndëve nuk i përkasin kategorisë “Profesor”, sikurse kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe numri i orëve në auditor të realizuar nga disa prej anëtarëve të personelit akademik të Departamentit të Biologjisë, tejkalon atë të përcaktuar në Udhëzimin e MAS (**Standardi IV.1, kriteri 1**).
5. Mungesa e përditësimit të literaturës për lëndët e programit të studimit gjatë 5 viteve të fundit. (**Standardi IV.3, kriteri 2**).
6. Mungesa e përfshirjes së të diplomuarve në përmirësimin e programit të studimit, si një mundësi për të marrë një feedback të vlefshëm dhe për të siguruar që programet e studimit të jenë relevante për tregun e punës (**Standardi II.5, kriteri 2**).

Rekomandime:

1. Institucioni, të rishikojë formatin e provimit të formimit për programin Bachelor në “Biologji-Kimi”, duke organizuar provime që mbulojnë të gjitha fushat e programit njëkohësisht, për të pasqyruar në mënyrë të plotë përmbajtjen dhe objektivat e programit (**Standardi II.1, kriteri 1 dhe 4; Standardi III.5, kriteri 1**).

2. Institucioni, të përfshijë në rregulloren e programit të studimit objektivat formuese dhe kompetencat që synohen të arrihen, për të qartësuar pritshmëritë dhe rezultatet e të nxënit për studentët (**Standardi II.4, kriteri 6**).
3. Institucioni, të zgjerojë bashkëpunimin me më shumë institucione private dhe publike për realizimin e praktikave mësimore dhe rritjen e kapaciteteve dhe përvojave të studentëve, si dhe të hartojë dhe publikojë raporte të detajuara analitike mbi impaktin e bashkëpunimit me institucione të ndryshme, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, për të vlerësuar në mënyrë efektive kontributin e tyre në realizimin e programit të studimit (**Standardi I.2, kriteri 3 dhe 4; Standardi II.5, kriteri 3**).
4. Institucioni, të marrë masa për caktimin si titullarë të lëndëve personeli akademik që i përket kategorisë “Profesor” dhe zbatimin e Udhëzimit të MAS lidhur me numrin e orëve në auditor të realizuar nga personeli akademik (**Standardi IV.1, kriteri 1**).
5. Institucioni, të sigurojë angazhimin e titullarëve të lëndëve në përditësimin periodik të materialeve mësimore për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e biologjikimisë (**Standardi IV.3, kriteri 2**).
6. Institucioni, të rrisë përpjekjet për gjurmimin e rrugëtimit profesional të studentëve të këtij programi studimi për të vlerësuar efektivitetin e programit në përgatitjen e tyre për tregun e punës, si dhe ti integrojë të diplomuarit në procesin e përmirësimit të programit të studimit (**Standardi II.4, kriteri 4; Standardi II.5, kriteri 2**).
7. Institucioni, të rrisë mundësitë për mobilitetin e studentëve, veçanërisht nëpërmjet projekteve Erasmus, për të nxitur shkëmbimin kulturor dhe akademik dhe për të rritur ekspozimin ndërkombëtar të studentëve (**Standardi III.4, kriteri 4**).
8. Institucioni, të intensifikojë konsultimet me partnerët institucionalë dhe grupet e ndryshme të interesit, për të siguruar që programi i studimit të jetë në përputhje me kërkesat aktuale dhe të ardhshme të tregut (**Standardi II.5, kriteri 1**).
9. Institucioni, të rishikojë dhe të qartësojë rregullat dhe procedurat për parandalimin e plagjiaturës, duke përcaktuar qartë masat disiplinore për rastet e shkeljes (**Standardi III.3, kriteri 5**).

Evaluation’s conclusions for the first cycle study program Bachelor in “Biology-Chemistry”, provided by the Higher Education Institution University “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Strengths and affirmations:

1. The institution has a long history of offering study programs, preserving and consolidating national and academic values.
2. The institution has the necessary infrastructure and capacities to offer study programs, including qualified academic staff and well-equipped laboratories, such as the Microbiological Diagnostic Center “Wolfdieter Sixl”, which also provides services to third parties and serves as a reference laboratory for Shkodër County, or the continuous training laboratory for ongoing training of academic staff with contemporary teaching methods.

Weaknesses:

1. The examination for student formation is conducted separately either in Biology or Chemistry, regardless of the fact that the study program is developed in both fields simultaneously (**Standard II.1, criteria 1 and 4; Standard III.5, criteria 1**).
2. The program regulation does not include the formative objectives of the study program, as well as the competencies aimed to be achieved through this program, which are only mentioned in the analysis of teaching-research work (**Standard II.4, criteria 6**).
3. The limited number of cooperation agreements for practical training of students and the lack of analytical reports on the impact of cooperation with various institutions within the framework of cooperation agreements, in order to achieve the study program's objectives (**Standard I.2, criteria 3 and 4; Standard II.5, criteria 3**).
4. Some of the course holders do not belong to the "Professor" category, as required by the current legal provisions, and the number of hours in the auditorium conducted by some members of the academic staff of the Department of Biology exceeds that specified in the MAS Guideline (**Standard IV.1, criteria 1**).
5. Lack of literature updating for the subjects of the study program during the last 5 years. (**Standard IV.3, criteria 2**).
6. Lack of inclusion of graduates in the improvement of the study program, as an opportunity to receive valuable feedback and ensure that study programs are relevant to the job market (**Standard II.5, criteria 2**).

Recommendations:

1. The institution should review the format of the formation exam for the Bachelor's program in "Biology-Chemistry", organizing exams that cover all areas of the program simultaneously, to fully reflect the content and objectives of the program (**Standard II.1, criteria 1 and 4; Standard III.5, criteria 1**).
2. The institution should include in the program regulation the formative objectives and the competencies aimed to be achieved, to clarify the expectations and learning outcomes for students (**Standard II.4, criteria 6**).
3. The institution should expand cooperation with more private and public institutions for the implementation of teaching practices and the enhancement of students' capacities and experiences, as well as to develop and publish detailed analytical reports on the impact of cooperation with various institutions, within the framework of cooperation agreements, to effectively assess their contribution to the realization of the study program (**Standard I.2, criteria 3 and 4; Standard II.5, criteria 3**).
4. The institution should take measures to designate academic staff as course holders who belong to the "Professor" category and implement the MAS Guideline regarding the number of hours in auditorium conducted by academic staff (**Standard IV.1, criteria 1**).
5. The institution should ensure the engagement of course holders in periodically updating teaching materials to reflect the latest developments in the field of biology-chemistry (**Standard IV.3, criteria 2**).



6. The institution should increase efforts to track the professional trajectory of students in this study program to assess the program's effectiveness in preparing them for the job market, as well as to integrate graduates into the process of improving the study program **(Standard II.4, criteria 4; Standard II.5, criteria 2)**.
7. The institution should increase opportunities for student mobility, particularly through Erasmus projects, to encourage cultural and academic exchange and enhance students' international exposure **(Standard III.4, criteria 4)**.
8. The institution should intensify consultations with institutional partners and various interest groups to ensure that the study program is in line with current and future market demands **(Standard II.5, criteria 1)**.
9. The institution should review and clarify rules and procedures for plagiarism prevention, clearly defining disciplinary measures for cases of violation **(Standard III.3, criteria 5)**.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, i PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI i CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X